



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 53

Prishtinë, më 7.6.2024, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Morën pjesë: Hydajet Hyseni- Kaloshi dhe Bahrim Shabani, zëvendëskryetarë, Drita Millaku, Arijeta Rexhepi, Enis Kervan, Valentina Bunjaku- Rexhepi, Shemsedin Dreshaj, Fridon Lala dhe Bekim Arifi, anëtarë.

Munguan: Elmi Reçica, Adem Hoxha dhe Fadil Gashi, anëtarë.

Të pranishëm të tjerë: Hysni Mehani, asistent i GP LVV; Orgest Topojani, asistent i GP PDK; Jeta Huraglica, asistente e GP LDK; Leonora Gashi, asistente e GP AAK; dhe Celal Iliaz, përfaqësues i Drejtorisë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni Kaloshi, zëvendëskryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 16 dhe 23.5.2024;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-272 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për noterinë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149, me raport-amendamente të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
4. Shqyrtimi i Projektligjin nr.08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me raport-amendamente të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;

5. Shqyrtimi i Projektligjin nr.08/L-275 për rrugët, me raport-amendamente të Komisionit funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë së Kosovës, me raport-amendamente të Komisionit Funksional për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes;
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë, me raport-amendamente të Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal;
8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur për Media, me raport-amendamente të Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 16 dhe 23.5.2024

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtur më 16 dhe 23.5.2024, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-272 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për noterinë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149, me raport-amendamente të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Zëvendëskryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.08/L-272, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për noterinë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149, me raport-amendamente të Komisionit funksional, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim.

Shemsedin Dreshaj, theksoi se nuk do t'i mbështesë projektligjet me amendamente të propozuara nga komisionet funksionale, sipas rendit të ditës, dhe do të abstenojë për votimin e të njëjtave.

Duke qenë se nuk pati propozime dhe sugjerime të reja nga anëtarët e Komisionit, dhe në bazë të rezultateve të votimit: për 6, kundër 0, abstenim 1, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.08/L-272 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për noterinë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149, me amendamente të Komisionit funksional, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet për miratim në seancë plenare.

4. Shqyrtimi i Projektligjin nr.08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me raport-amendamente të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Zëvendëskryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me raport-amendamente të Komisionit funksional, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim.

Meqë nuk pati diskutime, zëvendëskryetari konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit: për 6, kundër 0, abstenim 1, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me amendamente të Komisionit funksional, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet për miratim në seancë plenare.

5. Shqyrtimi i Projektligjin nr.08/L-275 për rrugët, me raport-amendamente të Komisionit funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim

Zëvendëskryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.08/L-275 për rrugët, me raport-amendamente të Komisionit funksional, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim.

Meqë nuk pati diskutime, zëvendëskryetari konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit: për 6, kundër 0, abstenim 1, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.08/L-275 për rrugët, me amendamente të Komisionit funksional, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet për miratim në seancë plenare.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë së Kosovës, me raport-amendamente të Komisionit funksional për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes

Zëvendëskryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë së Kosovës, me raport-amendamente të Komisionit funksional, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim.

Meqë nuk pati diskutime, zëvendëskryetari konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit: për 6, kundër 0, abstenim 2, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë së Kosovës, me amendamente të Komisionit funksional, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet për miratim në seancë plenare.

7. Shqyrtimi i Projektligjin nr.08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë, me raport-amendamente të Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal

Zëvendëskryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë, me raport-amendamente të Komisionit funksional, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim.

Meqë nuk pati diskutime, zëvendëskryetari konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit: për 6, kundër 0, abstenim 2, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë, me amendamente të Komisionit funksional, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet për miratim në seancë plenare.

8. Shqyrtimi i Projektligjin nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur për Media, me raport-amendamente të Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal

Zëvendëskryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur për Media, me raport-amendamente të Komisionit funksional, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim.

Meqë nuk pati diskutime, zëvendëskryetari konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit: për 6, kundër 0, abstenim 2, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur për Media, me amendamente të Komisionit funksional, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet për miratim në seancë plenare.

9. Të ndryshme

Enis Kervan, sa i përket zbatimit të planit të punës për vitin 2024, ai propozoi që Komisioni të vizitojë zyrtarisht Komunën e Prizrenit, me qëllim që të njihet me gjendjen e përgjithshme të komuniteteve, si dhe shkallën e zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Konkretizoi që të vihen kontakte me kryetarin e Komunës, kryetarin dhe anëtarët e Komisionit për Komunitete në këtë komunë.

Në kuadër të kësaj agjende, ai propozoi të vizitohet edhe Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, me qëllim që të informohemi me kriteret e reja të akreditimit nga AKA, pasi e njëjta nuk ka akredituar Fakultetin e Edukimit, në programet në gjuhën turke dhe boshnjake. Sipas qëndrimit të tij, nuk është zgjidhje institucionale, nëse nuk përmbushen kriteret e cilësisë në programet në gjuhën shqipe dhe paralelisht të mos akreditoen programet në gjuhën turke dhe boshnjake, pasi ky komunitet i plotëson kriteret e parapara me Ligjin për Arsimin e Lartë. Në pajtim me Kushtetutën, iu garantohet e drejta e arsimimit edhe komunitetit joshumicë, në nivel universitar.

Në Universitetin “Ukshin Hoti”, të vihen kontakte me rektorin, prorektorin, dekanin e Fakultetit të Edukimit dhe me stafin akademik të komuniteteve.

Zëvendëskryetari, theksoi se Komisioni ka bashkëpunim të ngushtë me misionin e OSBE-së, lidhur me procesin e monitorimit të ligjeve dhe çështjeve tjera në interes të komuniteteve. Sa i përket vizitës së planifikuar në Komunën e Prizrenit, më dt. 8.4.2024, e njëjta është anuluar me kërkesë të kryesueses së OSBE-së, pasi ajo paraprakisht e kishte agjendën e ngarkuar.

Enis Kervan, duke u përqendruar në identifikimin çështjes, propozoi që Komisioni të ftojë në raportim ministren e Arsimit dhe Agjencinë Kosovare për Akreditim, lidhur me akreditimin e programeve studimore në gjuhën mësimore të komuniteteve.

Shemsedin Dreshaj, theksoi se nuk është i vetmi problemi që Agjencia Kosovare për Akreditim, nuk i ka akredituar programet në gjuhën turke dhe boshnjake. I njëjti proces ka ndodhur me njësitë tjera akademike, të cilat janë në fazën e mbylljes, pasi iu pamundësohet regjistrimi në afatin e qershorit, në vitin paraprak.

Ai diskutoi lidhur me rastin e mosakreditimit të Universitetit të Bujqësisë, për arsye të mungesës së hapësirës, në fakt e njëjta ka funksionuar që 24 vite më parë. Për sigurimin e hapësirës nuk është përgjegjës njësia akademike, por barra i bie Ministrisë së Arsimit dhe rektorit.

Është shqetësuese çështja e mosakreditimit të programit mastar, ndërsa është hequr programi bachelor, në Universitetin e Bujqësisë. Për situatën aktuale, kërkohet përgjegjësi nga institucionet, që universitetet të jenë më funksionale.

Pajtohet me propozimin e deputetit Enis, që të ftohet në raportim ministrja e Arsimit dhe Agjencia Kosovare për Akreditim, me qëllim që të informohemi lidhur me ri-akreditimin e programeve dhe shpalljen e afateve të konkursit publik.

Arijeta Rexhepi, si anëtare edhe në Komisionin për Arsim, do të ofrojë disa sqarime lidhur me çështjen e ngritur. Ajo tha se Agjencia e Kosovës për Akreditim, është institucion përgjegjës për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë, përfshirë akreditimin, ri-akreditimin në institucionet e arsimit të lartë dhe programit studimor, konform Ligjit të AKA-së dhe Ligjit për Arsimin e Lartë.

Dha informatë shtesë, se Komisionit për Arsim, sipas agjendës, ka paraparë për javën e ardhshme të ftojë në raportim, ministren e Arsimit dhe Agjencinë e Akreditimit të Kosovës, lidhur me çështjen e ri-akreditimit në nivel institucional. Ajo ceku se do t’iu informojë zyrtarisht për rrjedhën e çështjeve të dala nga ky takim.

Valentina Bunjaku- Rexhepi, konsideroi se Komisioni për Arsim, me korrektësi e kryen punën e vet, por është e drejta e Komisionit tonë, të ftojë në raportim ministren e Arsimit dhe AKA-në.

Theksoi se në procesin e akreditimit, janë të angazhuar ekspertë ndërkombëtarë për vlerësim në fushat e standardeve të akreditimit, në nivel institucional.

Është shqetësuese çështja e mos-akreditimit të programit në gjuhën turke dhe boshnjake, apo rasti i mosakreditimit të programi master dhe bachelor.

Për arsyet e cekura, ajo ndan mendimin e njëjtë me deputetin Enis Kervan, që Komisioni të ftojë në takim ministren e Arsimit dhe AKA-në, por secili veçmas.

Zëvendëskryetari, në bazë të fushëveprimit të tij, Komisioni realizon vizita në terren në komuna, me qëllim që të njihen me gjendjen e realizimit të të drejtave dhe të interesave të komuniteteve.

Në pajtim me interesin e shprehur, ai konstatoi se Komisioni do të realizojë vizitën në Kuvendin e Prizrenit dhe në Universitetin “Ukshin Hoti”, më datë 28.6.2024.

Mbledhja përfundoi në orën 15:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Hydajet Hyseni Kaloshi,

Zëvendëskryetar i Komisionit